

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe Gani Avdiu e Burim Shala – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) Sh.A. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari H.I., kundër të paditurit I.B. nga fshati „,, komuna e Podujevës, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Podujevë C.nr.55/09, të datës 05.12.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit I.B. nga Podujeva, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Podujevë C.nr.55/09, i datës 05.12.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.55/09, të datës 05.12.2013, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, nga Prishtina, sh.a, dhe e ka detyruar të paditurin I.I.B. nga fshati „,,, Komuna e Podujevës, që t’ia paguaj paditësit shumën prej 76.13 € në emër të borxhit për impulset telefonike të harxhuara nga telefoni fiks në Podujevë nr. XXX-XXX, për muajt 10,11 dhe 12 - 2007 si dhe muajt 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 – 2008, me kamatë si e paguajnë bankat afariste të Kosovës për mjete të deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar prej ditës së nxjerrjes së aktgjyqimit të datës 05.12.2013, e deri në pagesën përfundimtare në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Po ashtu është detyruar i padituri që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 30 € në afat prej 7 ditësh nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak fakteve të gabuara dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Podujevë C.nr.55/09, të datës 05.12.2013, ta hedh poshtë të pa bazuar apo të njëjtin ta anulojë dhe çështjen t’ia kthej në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Podujevë.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit, është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 18.11.2008, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar propozim përmbarimi, në bazë të dokumentit të besueshëm (faturave), me arsye sikurse në propozim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të paditëses ka nxjerrë aktvendimin Ekz.nr.968/08, me të cilën e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit t'i paguaj kreditorit shumën prej 76.13 €, si dhe shpenzimet faktike të përmbarimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I padituri me datë 10.12.2008, ka parashtruar kundërshtim kundër aktvendimit mbi Ekzekutimin e Gjykatës Komunale në Podujevë Ekz.nr.968/08, të datës 18.11.2008, me propozim që në shqyrtim kryesor të provave ta anulojë vlerësimin e bërë të datës 18.11.2008 dhe të shërbehet me faktet të cilat do t'i ofrojë dhe do të shërbehet me gjendjen reale dhe faktike.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kundërshtimit të të paditurit me datë 11.12.2008, ka nxjerrë aktvendimin E.nr.968/2008, me të cilin e ka pezulluar procedurën përmbaruese të lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate E.nr.968/2008, të datës 18.11.2008 dhe i ka shkëputur të gjitha veprimet e ndërmarra të gjertanishme përmbaruese, duke konstatuar se procedura në këtë çështje juridike do të vazhdojë në kontest të rregullt juridiko – civil.

Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.55/09, të datës 05.12.2013, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga faturat të cilat gjenden në shkresat e lëndës të ofruara nga kreditori të gjitha janë në emër të debitorit të paditurit I.B., po ashtu është cekur edhe shuma e borxhit që ka ai dhe për çdo muaj i ka shkuar njoftimi në shtëpi përmes faturave e që shuma e përgjithshme ka arritur si e pa paguar prej 76.13 €. Gjithashtu ka theksuar se pretendimet tjera të paditurit në kundërshtim se nuk e ka shfrytëzuar fare atë numër të telefonit duke i propozuar gjykatës që aktvendimin ta anuloj dhe të mbaj shqyrtimin kryesor që do ta dëshmoj me prova se ai ka të drejtë mirëpo i padituri nuk e ka shfrytëzuar atë të drejtë me prezantua në shqyrtim fare dhe as që ka qenë i interesuar që të marrë pjesë, andaj nuk qëndrojnë thëniet e tija në kundërshtim pasi që nuk ka argumentuar as një provë të kundërt. Vendimin mbi shpenzimet e ka nxjerrë në mbështetje të nenit 449.1, 452 dhe 453 të LPK-së, sipas së cilës është obliguar i padituri të paguaj në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30 € dhe atë 15 € për padi dhe 15 € për aktgjykim.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar

në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa pretendimet tjera për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga ana e ankuesit nuk janë paraqitur.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore me të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në arsyetim të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dispozitës së nenit 8 dhe 423 paragrafi 4 i LPK-së, në atë mënyrë që ka përshkruar faktet që kanë parashtruar palët, provat e propozuara dhe të administruara, si dhe mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e atakuar, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 262 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) parashihet se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të kësaj dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.501/14, me datën 17.08.2018

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj